



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 6 maj 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratuan procesverbalet e mbledhjeve të Bordit: nr. 16, datë 02.04.2026; nr. 17, datë 09.04.2026; nr. 18, datë 14.04.2026; nr. 19, datë 21.04.2026 dhe nr. 20, datë 24.04.2026.

U miratua kërkesa e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U miratua kërkesa e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

U miratua kërkesa e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaiik.

U vendos fillimi i procedurës për miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017.

U vendos fillimi i procedurës për miratimin e Licencës Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla.

U vendos fillimi i procedurës për miratimin e Licencës Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi rishikimin e programit të transparencës.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.